



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZI.Anr.86/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së banerit mbi rrugë publike për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 03.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ndërkaq subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Ferizaj, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 600.00 (gjashtëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

Me datën 27.09.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me të cilën pretendon se me datën 27.09.2017, në hyrjen e fshatit Dubravë, Komuna e Ferizajit te vendi i quajtur tek “Mahallët” një aktivist i tyre ka vërejtur se mbi rrugë publike është vendosur baneri me emrin dhe foton e kandidatit për Kryetar dhe kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal të Ferizajit nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33 pika b), të LPZ-së, të nenit 4.1 pika b të Rregullës Zgjedhore nr.11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur dy fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë nga subjekti politik AAK, të datës 28.09.2017, ka deklaruar se vendosja e banerit të kandidatëve të tyre mbi rrugë publike nuk është bërë nga ana e strukturave të AAK-së dhe se atë mund ta ketë vendosur ndonjë qytetar apo individ i pa identifikuar, megjithatë me të pranuar njoftimin për ankesë kanë kontaktuar strukturat e partisë në Ferizaj të cilët kanë ndërmarrur masat përmirësuese, për evitimin e shkeljes sipas ankesës. Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkëngjitur dy fotografi nga vendi ku është larguar baneri.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

## **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografit e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se baneri i kandidatit për kryetar dhe kandidates për anëtare të Kuvendit Komunalë në Ferizaj nga radhët e subjektit politik AAK është vendosur mbi rrugë publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik AAK, është shkëlur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që baneri i kandidatit për kryetar dhe kandidates për anëtare të Kuvendit Komunalë të këtij subjekti, është vendosur mbi rrugë publike.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër të këtij fakti baneri i kandidatëve të këtij subjekti politik janë vendosur në hapësirë dhe në rrugë publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që subjektit politik në fjalë, iu dha mundësia për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë hequr banerin nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitja**

Anr. 86/2017 më datën 03.10.2017



***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4 të LZP-së.***